



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0061628-2/24 dt. 23.09.2024**  
**Mitrovicë**

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E MITROVICES / OPŠTINA MITROVICA

02 Nr. Pro/L/Br. Pro/L/ 02-060/01-0061628-2/24  
Nr i sq./Br. sq. \_\_\_\_\_  
Date/Datum 23. 09. 2024  
Selosia Mitrovicë - Mitrovica

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, nenin 24 dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi b, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 61, të Ligjit Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; Qarkoret Buxhetore 2025/01 dhe 2025/02; nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenin 20, paragrafi 2, neneve: 28, dhe 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Statutit të Komunës; Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-27 Nr. 02-060/01-0040771-2/24 dt. 26.06.2024; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 23.09.2024, pasi shqyrtoi Draft-Buxhetin për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0059372-2/24 dt. 12.09.2024); sjell këtë:

### VENDIM

#### **Për miratimin e Buxhetit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2025 dhe parashikimi për vitet 2026-2027**

1. MIRATOHET Buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2025 dhe parashikimi për vitet 2026-2027.
2. Shuma e Buxhetit për vitin 2025, është 30,240,514.00 €.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është tabela e Planit të Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit  
1 x 1 MAPL  
1 x 1 Arkivit  
Kopje: Kryetarit të Komunës  
Të gjitha drejtorive



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA